



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Nr. 1213, Prot. Dt. 08.07. 2026

Nr. 11326/Prot. Dt. 15.07 2026

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) si institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë që ka për mision lehtësimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe të licencimit, lejimit, autorizimit dhe mbështetjes së institucioneve publike në vendimmarrjen për krijimin e një mjedisi rregullator miqësor, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Etugert LLAZI;

dhe

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organ i pavarur, i cili rregullon veprimtarinë në fushën e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetarja, Zj. Armela KRASNIQI;

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- Vendimit të Kryeministrit nr. 179, datë 09.03.2016 "Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Biznesit";
- Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Palët bien dakord të lidhin këtë memorandum bashkëpunimi (më poshtë referuar si memorandum).

Neni 1

Qëllimi

Memorandumi ka për qëllim rritjen e shkallës së bashkëveprimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në fushat me interes të përbashkët për një funksionim sa më efektiv dhe pëmirësimin e veprimtarisë së institucioneve për garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me transparencën e pronësisë së shoqërive mediatike, identifikimin e pronarëve të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe përfitues, si dhe forcimin e integritetit dhe besueshmërisë së tregut audioviziv.

Neni 2

Fushat e përbashkëta të përgjegjësisë

1. AMA dhe QKB do të bashkëpunojnë në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" në garantimin e transparencës së pronësisë mediatike.
2. Të dy palët angazhohen për të garantuar respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parimit të proporcionalitetit.
3. AMA dhe QKB do të bashkëpunojnë në drejtim të shkëmbimit periodik dhe në kohë reale të informacionit dhe të dhënave mbi strukturën pronësore të subjekteve tregtare të licencuara/autorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit mediatik.
4. Palët angazhohen për përcaktimin e procedurave teknike dhe administrative për shkëmbimin e sigurt të informacionit.

Neni 3

Angazhimet e Palëve

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) angazhohet:

- a. Të sigurojë aksesimin e Regjistrit të pronësisë së OSHMA-ve, të administruar dhe publikuar nga AMA, me qëllim garantimin e transparencës së pronësisë të shoqërive mediatike.
- b. Të bashkëpunojë me QKB-në për shkëmbimin e informacionit identifikues që lidhet me të dhënat e regjistruara të subjekteve mediatike, me qëllim rritjen e transparencës së pronësisë dhe garantimin e identifikimit të plotë të pronarëve dhe përfituesve përfundimtarë.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) angazhohet:

- a. Të bashkëpunojë me AMA-në duke vënë në dispozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statistika mbi të dhënat e Regjistrit Tregtar dhe të Regjistrit të Pronarëve Përfitues që administron, për qëllime verifikimi dhe kryqëzimi të deklarimeve të bëra nga subjektet tregtare të licencuara/autorizuara nga AMA si ofrues të shërbimeve mediatike, lidhur me :

- a) emrin ose emrat e pronarëve të tyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që kanë aksione dhe u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarrjen strategjike, duke përfshirë pronësinë direkte ose indirekte nga një shtet ose nga një autoritet ose subjekt publik;
- b) emrin ose emrat e pronarëve të tyre përfitues;
- c) të sigurojë informacion për AMA-në mbi aktivitetet e tjera tregtare të subjekteve të licencuara/autorizuar nga AMA, pas kërkesës së kësaj të fundit.

Neni 4

Procedura për shkëmbimin e informacionit

1. AMA dhe QKB shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, në fushat me interes të përbashkët në mënyrë efikase dhe duke shmangur vonesat burokratike.
2. Shkëmbimi i informacioneve bëhet sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënigjore në momentin e nënshkrimit të këtij memorandum.
3. Procesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për atë që lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetin në përshpejtimin e kohës së shkëmbimit të informacionit dhe vullnetin pozitiv për të vënë në dispozicion informacionin e disponueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Organizimi i aktiviteteve

1. Kur vlerësohet e përshtatshme, palët do të organizojnë aktivitete dhe tryeza të përbashkëta me fokus rolin që luan secili nga institucionet në garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me transparencën e pronësisë së shoqërive mediatike, identifikimin e pronarëve të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe përfitues, si dhe forcimin e integritetit dhe besueshmërisë së tregut audioviziv.
2. Të dyja palët do të organizojnë aktivitete trajnuese dhe ndërgjegjësuere për domosdoshmërinë e deklarimit të informacioneve të lidhura me pronësinë mediatike, të cilat duhet të jenë të aksesueshme lehtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përhershme për marrësit e një shërbimi me qëllim sigurimin e transparencës së pronësisë në tregun mediatik.

Neni 6

Përdorimi i informacionit dhe ruajtja e konfidencialitetit

1. Secila nga palët do ta përdorë informacionin e marrë vetëm për rastet e ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara rast pas rasti.
2. Veprimet e kryera nga palët sipas këtij memorandum dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrotjen e të dhënave personale.
3. Çdo palë e kësaj marrëveshjeje duhet të ruajë informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për mbrotjen e të dhënave personale.
4. Informacioni i marrë në kuadër të këtij memorandum nuk mund të transferohet një pale të tretë pa pasur një autorizim me shkrim nga pala e cila ka siguruar informacionin.

Neni 7

Koherenca e takimeve mes palëve

1. Titullarët e palëve respektive do të takohen dhe do të rishikojnë e vlerësojnë përparimin e arritur çdo 6 muaj, si dhe do të përditësojnë masat e nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara kur është e nevojshme për sa i përket zbatimit të këtij memorandumi, në mënyrë që të rendisin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize dhe vazhdimin e tij, shkëmbimin e pikëpamjeve, me qëllim që të ndërtohet një sferë sa më e sigurt dhe efikase, sa i përket zbatimit të ligjit për garantimin e transparencës pronësore në sektorin e mediave audiovizive.
2. Me iniciativen e secilës palë, për probleme të caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë edhe në nivel hierarkik të ndryshëm nga titullarët e intitucioneve respektive.

Neni 8

Afati i Memorandumit

1. Ky memorandum lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Bashkëpunimi mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.

Neni 9

Përmirësimet dhe ndryshime

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë memorandum bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e secilës prej palëve, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 10

Pika e kontaktit

1. Secila prej palëve do të caktojë nga një përfaqësues, në cilësinë e personit të kontaktit për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit në nivel teknik.
2. Palët do të njoftohen reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Në zbatim të këtij memorandumi, personat e kontaktit do të jenë;

Për QKB : Znj. Geljada Llupo-Specialist, Drejtorja e Regjistrave dhe Analizës

Për AMA: Znj.Tea Marena- Shef.Sektori, Drejtorja e Legjislacionit dheIntegritimit European

Neni 11
Dispozita përfundimtare

1. Memorandumi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga palët.
2. Ky memorandum nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) për secilën palë.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë _____. 2026.

**AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Armela KRASNIQI



**QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT**

Etugert LLAZI

